



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 25, datë 17.03.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“RIKONSTRUKSION BUJTINA “KOL GJONI” DHE OBJEKT SHITESË NË FUNKSION  
TË OBJEKTIT EKZISTUES”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TROPOJË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Z. Bledar Jubani, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion bujtina “Kol Gjoni” dhe objekt shtesë në funksion të objektit ekzistues”, me vendndodhje në Bashkinë Tropojë, me zhvillues Z. Bledar Jubani.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tropojë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

